

**Intervista e Ministrit të Financave Avdullah Hoti në “Zëri i Amerikës” në edicionin e lajmeve në gjuhën shqipe “Ditari”**

*18 prill 2015*

**Znj. Laura Konda:** Në Uashington po mbahen këtë javë takimet e pranverës të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku përfaqësuesit e financave dhe ekonomisë të vendeve të ndryshme të botës këmbëjnë eksperiencat e tyre.

Në këto takime po merr pjesë edhe Ministri i Financave i Kosovës, Avdullah Hoti, të cilin e kemi sot të ftuar në një bisedë në studio.

**Znj. Laura Konda:** Mirëdita z. Ministër!

**Ministri Avdullah Hoti :** Mirëdita , faleminderit për ftesën!

**Znj. Laura Konda:** z. Ministër para se të kalojmë të çështjet e tjera që lidhen me ekonominë e Kosovës, cili është komenti i juaj për protestën e sotme ku morën pjesë siç pamë mijëra qytetarë të Kosovës?

**Ministri Avdullah Hoti :** Unë mora vesh që protesta përfundoj e qetë, e që është një lajm shumë i mirë.

E drejta për të protestuar normalisht është e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe është e drejtë e secilit qytetarë të shpreh pakënaqësitë. Është mirë që përfundoj e qetë, u dha mesazhi, kërkesat që i kanë protestuesit dhe partitë opozitare, por kjo Qeveri është zgjedhur me vota të lira, me vota demokratike është votuar në parlament, është në muajt e parë të qeverisjes dhe disa prej deklaratave të partive opozitare sikur nuk janë shumë të bazuara, për mendimin tim nuk ka ndonjë kauzë të fortë për të protestuar. Përkundrazi është koha që të bëhemi bashkë, të bëhet një opozitë konstruktive, kritikuese ndaj vendimeve dhe ndaj qasjes që ka strategjia.

Ne tani i kemi të qarta mënyrat, projektet tona dhe masat që do të ndërmerren për 4 vitet e ardhshme. Kemi përgatitë një program qeverisës që është dërguar në Kuvend, është debatuar në fakt me partitë opozitare dhe është mbrojtur edhe para tyre. Tani po punojnë në strategji,

në Kornizën e Shpenzimeve dhe projektet për 4 vitet e ardhshme dhe është vendi ku duhet të bëhet opozita mendoj që është në Kuvend. Por, sidoqoftë protesta është shprehje e kërkesave të qytetarit, por është mirë që të mbahet gjithmonë e qetë.

**Znj. Laura Konda :** z. Hoti por nuk është çështja thjeshtë se kjo është një protestë. Protesta drejtohet sepse Kosova vërtetë është në një gjendje kritike, sidomos është ajo e papunësisë, kryesisht në mes të rinjve që janë mbi 60% të rinj të Kosovës apo në çdo 3 djem apo vajza të Kosovës vetëm 1 punon. Çfarë masa po merr Qeveria e juaj për të hapur vende pune për rininë e saj që të mos largohet nëpër rrugët e Evropës?

**Ministri Avdullah Hoti:** Ne kemi prezantuar një program qeverisës për 4 vitet e ardhshme që i adreson këto kërkesa të cilat sot opozita i ka shpreh në rrugë përmes protestave. Është programi i punësimit, që kemi filluar në fakt një pjesë të këtij programi edhe ta zbatojmë, është pakjoja fiskale të cilën e kemi aprovuar në Qeveri dhe tani është në Kuvend, besoj shpejt do të kaloj edhe në Kuvend. Janë masa të tilla të cilat adresojnë këto nevoja, që besoj do të përmirësojnë ambientin për biznes, do të krijojnë potenciale zhvillimore dhe do t'i adresojnë nevojat sociale. P.sh Vetëm përgjysmimi i TVSH-së (Tatimit në Vlerën e Shtuar) në energji, në ujë, në bukë dhe në produktet elementare, besoj se e përgjysmon ngarkesën tatimore sidomos për familjet me të ardhura të ulëta dhe me të ardhura të mesme, që është kërkesë e protestuesve ta zëmë për çmimin e energjisë elektrike.

Është lirimi nga TVSH-ja i krejt makinerisë prodhuese që importohen nga vendet e huaja, është lirimi nga TVSH-ja dhe nga ngarkesat doganore të lëndës së parë që nuk prodhohet në Kosovë, që është një lirim shumë i madh për të bërë biznes në Kosovë.

Kemi marrë masa bukur drastike në kontrollin e financave publike. Unë shpejtë do të dërgojë në Parlament Raportin tre mujor të shpenzimeve dhe të hyrave, për tre muajt e parë të këtij viti, dhe ndryshimet me tremujorin e vitit 2014 janë shumë të mëdha, ka afër 20 % kursime në të gjitha kategoritë e shpenzimeve.

Këto janë masat që unë besoj që veç kanë filluar të japin efekt, por do të japin efekt në pjesën e dytë të këtij viti dhe në vitet e ardhshme. Kemi dyfishuar subvencionet për bujqësi për të mundësuar zvogëlimin e importit shumë të madh të produkteve bujqësore.

Kemi marr masa në administratë për tu siguruar që njerëz që janë brenda Administratës, sidomos të prokurimit publik kanë etikë të lartë profesionale dhe zyrtare. Kemi filluar të punojnë në projektin e prokurimit elektronik për të evituar çfarëdo kontakte të zyrtarëve me kompanitë.

Janë një sërë masash që pothuajse adresojnë shumicën e çështjeve të ngritura në protestë. Pra po punojnë në ato, nuk është çështje e presionit të sindikatave dhe të protestuesve por se është pjesë e programit të Qeverisë.

**Znj. Laura Konda :** Çfarë pritet në fushën e investimeve në Kosovë? Kosova ka një termocentral të amortizuar, shumë të vjetër, që përveç se nuk funksionon me kapacitetet e duhura po ndot mjedisin për qytetarët e Kosovës. A pritet të ketë së shpejti ndonjë investitorë për ta ndërtuar termocentralin e ri të Kosovës ?

**Ministri Avdullah Hoti:** Ka një kohë që po e negociojmë një projekt shumë të madh për ndërtimin e termocentralit të ri dy herë nga 300 Megavat. Jemi në fazën e fundit të procesit të përzgjedhjes së investitorit. Po negociojmë me të, por problemi është se në fund të procesit ka mbet vetëm një ofertues, tani po negociojmë me ta bashkë me Bankën Botërore dhe me këshilltarët tjerë të transaksionit për këtë projekt. Unë besoj do të përmbyllen këto negociata me sukses brenda 2 muajve në maksimum dhe do të dihet mandej për mënyrën se si do të investohet në këtë projekt madhor.

**Znj. Laura Konda :** Nga takimet që ju keni pasur këtu me zyrtarë të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, çfarë programesh konkrete priten, a keni ndonjë të re nga miratimi, ndonjë program specifik për Kosovën, për rritjen e ekonomisë së Kosovës, zbutjen e varfërisë ?

**Ministri Avdullah Hoti:** Në 3 ditët e fundit unë kam qenë këtu në biseda në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore dhe e them me kënaqësi që kanë qenë biseda shumë të frytshme, sidomos pasi që ne jemi tani në muajt e parë të qeverisjes . Duket që Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore i dinë nevojat që i kemi ne si vend, kufizimet buxhetore që i kemi ne si ekonomi e re, si vend i ri. Në parim kemi një pajtueshmëri reciproke për natyrën e marrëdhënieve që duhet të kemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe mbi këtë bazë pastaj me Bankën Botërore.

Normalisht, Fondi Monetar Ndërkombëtar është shumë i koncentruar në qëndrueshmërinë fiskale, ne i kemi siguruar zyrtarët e FMN-së që do të mirëmbajmë këtë qëndrueshmëri fiskale, por mbi këtë qëndrueshmëri fiskale ne duhet të krijojmë hapësirë për projekte të mëdha zhvillimore. Dhe bisedat që i kemi pas me Bankën Botërore në këtë drejtim kanë qenë shumë të frytshme, janë projekte konkrete që ne i kemi prezantuar para tyre si ide, të cilat do t'i

përfshijmë tash në planet për 3 vitet e ardhshme dhe do të kërkojmë financim prej Bankës Botërore. Janë dy projekte të mëdha në fushën e bujqësisë, të ujitjes së tokave bujqësore të cilat do të dyfishojnë hapësirat bujqësore në ujitje, është projekti i formatizimit të plotë të shkollave, modernizimit të sistemit shëndetësor, i rivitalizimit të hekurudhave dhe 2 – 3 projekte tjera pak më të vogla që shkojnë përtej kapaciteteve tona financiare që i kemi për t'i buxhetuar këto projekte.

**Znj. Laura Konda** : z. Hoti koalicioni juaj qeveritar erdh me premtimin për rritjen e pagave, ishte një premtim i fushatës pra ky. Dhe javën e ardhshme priten protesta të reja të punonjësve të sektorit publik pikërisht për rritjen e pagave, si do të veprohet, çfarë ka menduar Qeveria për të rritur pagat?

**Ministri Avdullah Hoti**: Ne tani jemi duke e zhvilluar Ligjin e pagave për të punësuarit në sektorin publik, përfshirë edhe arsimin, shëndetësinë dhe sektorët e tjerë.

Ne në atë Ligj po planifikojmë të vendosim një kornizë ligjore brenda të cilës përcaktohen pagat, që pagat të mos caktohen në të ardhmen përmes vendimeve ekzekutive të Ministrit ose të Kryeministrit ose dikujt tjetër, por të jetë një kornizë ligjore. Ta zëmë në bazë të kualifikimeve, përvojës të punës, por edhe në bazë të rritjes ekonomike që ka vendi, normës të inflacionit dhe indikatorëve tjerë për të ruajtur fuqinë blerëse të pagave. Sindikatat do të jenë pjesë e diskutimeve në përgatitjen e këtij Ligji. Unë besoj që shumë shpejtë Ligji do të dalë në diskutim publik dhe do të shkojë në Parlament për aprovim, dhe besoj që edhe sindikatat do ta përkrahin, sepse në fund të fundit ato resurset të kufizuara që i kemi ne duhet t'i shpërndajmë baras tek të gjithë anëtarët e shoqërisë.

**Znj. Laura Konda** : z. Hoti faleminderit për intervistën!

**Ministri Avdullah Hoti**: Ishte kënaqësi!